




OBSERVATORI PËR TË DREJTAT E FËMIJËVE

Raport studimor “Analiza e treguesve të rinj që monitorojnë të drejtat e fëmijëve” për vitin 2012 - Qarku Elbasan



QARKU ELBASAN

Eksperte Rajonale
Bruna Çoku
Prill 2014

Lista e Shkurtimeve

ASHMDF	-Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve
DRSHS	– Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social
IT	- Information Technology (Teknologji informacioni)
DRSKSH	– Drejtoria Rajonale e Sigurimeve dhe Kujdesit Shëndetësor
DAR	– Drejtoria Arsimore Rajonale
DSHP	– Drejtoria e Shëndetit Publik
NJDF	– Njësia për të Drejtat e Fëmijëve
NJMF	– Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve
VKM	– Vendim i Këshillit të Ministrave
Observatori	- Observatori për të Drejtat e Fëmijëve
DPGJC	– Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile
NE	– Ndihe Ekonomike
MPCSSHB	– Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta

I - Parathënie dhe falënderime

“Observatori për të Drejtat e Fëmijës”, tashmë është një organizatë Shqiptare, e cila është ngritur dhe po fuqizohet falë mbështetjes së zyrës së UNICEF – Shqipëri. Observatori operon në çdo qark të Shqipërisë me zyrat e saj përkatëse, duke shërbyer si një mekanizmin për mbledhjen e informacionit dhe studimin e situatës së realizimit të të drejtave të fëmijëve në nivel rajoni. Zyra e Observatorit, harton raporte bazuar në realizimin e të drejtave të fëmijës me shtrirje gjeografike në të gjithë territorin e Shqipërisë, duke u mbështetur në analizën e 140 treguesve të ndryshëm.

Në rajonin e Elbasanit, Observatori ushtron veprimtarinë e tij që në Maj të vitit 2009. Përveç mbledhjes së treguesve për të drejtat të fëmijëve në sektorë të ndryshëm, si : arsim, shëndetësi, punësim, ndihmë ekonomike, Observatori ka realizuar edhe një studim në nivel qarku lidhur me analizën e treguesve të rinj që monitorojnë të drejtat e fëmijëve, i cili do të pasqyrohet në këtë raport.

Observatori për të Drejtat e Fëmijëve ka ngritur urat e bashkëpunimit me të gjitha institucionet, drejtoritë, strukturat vendore dhe lokale të cilat kanë në fokusin e tyre fëmijët. Disa prej këtyre Institucioneve me të cilat Observatori ka nënshkruar dhe marrëveshje bashkëpunimi janë: Drejtoria Arsimore rajonale, Drejtoria e Shëndetit Publik, Drejtoria rajonale Spitalore, Drejtoria e Policisë, Drejtoria rajonale e Shërbimeve Sociale. Gjithashtu bashkëpunimi dhe komunikimi intensiv me njësitë vendore të qarkut Elbasan është një element i rëndësishëm dhe shumë i dobishëm. Tashmë Observatori Elbasan ka nënshkruar 55 Marrëveshje Bashkëpunimi. Gjithashtu Observatori mbetet i hapur për të bashkëpunuar me çdo institucion i cili ka në fokus fëmijët.

Një arritje e rëndësishme e projektit në nivel lokal: Observatori ka arritur të kontribuojë në hartimin e strategjisë për të drejtat e fëmijëve për Qarkun Elbasan, të mbledhë të dhënat për disa tregues sipas VKM-së, të monitorojë dhe të vlerësojë në çdo kohë situatën e fëmijëve në qark, të jetë pjesëmarrës në veprimtari dhe iniciativa me në fokus fëmijët, të organizuara me aktorë të ndryshëm, si organizata, shkolla, institucione, njësi vendore, etj.

Në këtë Raport Observatori për të drejtat e fëmijëve, Qarku Elbasan, u fokusua tek analiza e treguesve të rinj që monitorojnë të drejtat e fëmijëve në Qarkun Elbasan.

Falë punës dhe angazhimit çdo dite të Observatorit në Qarkun Elbasan, është rritur ndërgjegjësimi lokal për të drejtat e fëmijëve lidhur me monitorimin nëpërmjet treguesve statistikore, të kombinuar me vlerësimin nëpërmjet pjesëmarrjes. Në këtë proces ndërgjegjësimi e bashkëpunimi, Observatori është vlerësuar jo vetëm si mjet për monitorimin e të drejtave të fëmijëve, por si një metodologji e cila mund të përdoret për monitorimin e politikave dhe strategjive të zhvillimit lokal në përgjithësi dhe integrimin e çështjeve që lidhen me të drejtat e fëmijëve në nivel lokale e rajonale.

Në punën e tij Observatori ka arritur të konsolidojë një bashkëpunim të ngushtë me të gjitha strukturat lokale dhe rajonale, OJF-të, shkollat, njësitë e qeverisjes vendore, komunitetin e nxënësve dhe prindërve, etj. Ky partneritet është i rëndësishëm, pasi secili nga partnerët e mësipërm ka një rol shume të pazëvendësueshëm në respektimin e të drejtave të fëmijëve në shkollë, familje dhe komunitet.

Për kontributin e dhënë në përmbushje të misionit dhe detyrës së Observatorit Elbasan nga pozicioni i ekspertes rajonale shkon një falënderim për bashkëpunimin në këtë proces për Znj. Lumturi Latifi Përgjegjëse e zyrës së statistikave DSHP Elbasan, Znj. Najada Kokoneshi eksperte e NJDF Qarku Elbasan, Znj. Sonila Banja Përgjegjëse e statistikave DAR Elbasan, etj.

Një falënderim i veçantë shkon për stafin e Observatori për të drejtat e Fëmijëve Znj. Elma Tërshana, Drejtore Ekzekutive, Znj. Mina Mata Administratore Kombëtare e të dhënave, znj. Ermira Zaçe financiere.

Mbështetja e tyre ka qenë mjaft e rëndësishme në përgatitjen e këtij raporti, por dhe në gjithë punën e Observatorit Elbasan që nga fillimi. Në sajë të mbështetjes së tyre është bërë e mundur përpunimi i të dhënave në sistemin DeviInfo, një sitem i çertifikuar nga EU, si dhe është bërë i mundur përdorimi dhe konsultimi me raporte kombëtare dhe ndërkombëtare.

II - Hyrja

Referuar Ligjit nr 10 347 mbi të drejtat e fëmijëve është ngritur dhe studimi me temë “Treguesit e Rinj”. Ky ligj ka për qëllim të marrë masat që çdo fëmijë të gëzojë të drejtat e tij/saj në përputhje me stadin e zhvillimit dhe të bazuar në interesin më të lartë të tij/saj. Këtij ligji i janë bashkëngjitur dhe disa VKM mbi çështjet e të drejtave të fëmijëve, të cilat janë:

1. VKM nr. 263, datë 12.04.2012 “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme , për bashkëpunimin midis mekanizmave institucionalë dhe organizatave jofitimprurëse , për realizmin e politikave vendore për mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve”
2. VKM 265, datë 12.4.2012 “Për krijimin dhe funksionimin e mekanizmit të bashkërendimit të punës ndërmjet autoriteteve shtetërore, përgjegjëse për referimin e rasteve të fëmijëve në rrezik, si dhe mënyrën e proçedimit të tij”.
3. VKM Nr. 266, datë 12.04.2012, - Për bashkërendimin e veprimtarisë së mekanizmave në nivel qendror dhe vendor për çështjet që lidhen me mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës.
4. VKM nr. 267, datë 12.04.2012 për llojet, mënyrën e shkëmbimit dhe të përpunimit të informacionit dhe të dhënave statistikore nga Agjencia (ASHMDF) e nga strukturat shtetërore përgjegjëse, në nivel qendror dhe vendor.

Raporti ka si synim identifikimin e problemeve që hasin fëmijët në Qarkun e Elbasanit, duke u përpjekur për të dhënë një tablo sa më të plotë të vështirësive që hasen nga fëmijët në jetën e përditshme dhe rekomandimet përkatëse për përmirësimin e situatës lidhur me respektimin e të drejtave të tyre.

Realizimi i raporteve të tilla studimore, ndihmon në përmirësimin e cilësisë së jetës së fëmijëve, e duke i bërë ato pjesë të proçeseve zhvilluese në vend. Çdo individ i shoqërisë sonë gëzon dhe duhet t’i garantohen të drejtat bazë në arsimim, shërbime shoqërore dhe integrim në shoqëri¹. Studimi do të synojë paraqitjen e tablosë së kësaj situatë për vitin 2012 për Qarkun Elbasan.

Hartimi i këtij raporti, synon t’u vijë në ndihmë Bashkive dhe Komunave të Qarkut Elbasan në përgjithësi, dhe në veçanti institucioneve për fëmijë, me qëllimin e përmirësimit të kushteve dhe standardeve të jetesës së fëmijëve me nevoja të veçanta.

Ky raport i’u shërben dhe agjencive, NJDF në Qark, institucione, donatorë apo persona të interesuar, të cilët kanë dëshirën e mirë për të bërë diçka pozitive në gjithëpërfshirjen dhe në garantimin e respektimit të të drejtave të fëmijëve në përputhje me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare.

Në Qarkun Elbasan, hartohen raporte periodike statistikore lidhur me të drejtat e fëmijëve.

Krahas përgatitjes së treguesve statistikore me të cilët Observatori punon që nga viti 2009, ai bën të mundur dhe përgatitjen e studimeve mjaft cilësore në lidhje me situatën e të drejtave të fëmijëve në Qarkun e Elbasanit.

Këto studime mbështeten në treguesit e përpunuar të cilët observatori mbledh në vazhdimësi lidhur me të drejtat e fëmijëve në përgjithësi.

Të dhënat e grumbulluara për hartimin e këtij raporti i referohen situatës së përgjithshme për fëmijë në tregues të ndryshëm , pa i’u referuar një kategorie të caktuar brenda grupimit “fëmijë”¹.

¹ Raport “ realizimi i të drejtave të Fëmijëve në Shqipëri 2008-2009” Alenaca Kombëtare/
Observatori Kombëtar për të Drejtat e Fëmijëve, 2010

Informacionet e përfshira në këtë raport merren në bashkëpunim me institucionet lokale dhe rajonale Elbasan (të dhënat statistikore), nga takime dhe intervista me aktore lokale.

Ashtu si dhe në raportet e mëparshme, edhe në këtë raport u përdor metoda e analizës së kryqëzuar midis burimeve primare dhe sekondare. Për të siguruar informacion primar, u realizuan intervista me përfaqësues të institucioneve shtetërore dhe agjencive joqeveritare që punojnë me dhe për fëmijët.

Të dhënat dytësore u mundësuan nga shfrytëzimi i literaturës ekzistuese, vendase dhe të huaj. Shfrytëzimi i literaturës ekzistuese (studime, raporte, artikuj të realizuar nga studiues vendas dhe organizata lokale e ndërkombëtare, ligje dhe politika të shtetit shqiptar nga viti 1990 e në vijim) ka shërbyer për të identifikuar problematikën mbi të cilën duhet hulumtuar dhe mangësitë në legjislacion, sidomos në drejtim të zbatimit të tij.

Intervistat me aktorët kyç në fushën e shërbimeve për fëmijët , intervistat me profesionistët (mjekë, mësues, punonjës, policie, juristë, punonjës socialë dhe psikologë) si dhe intervistat me prindër dhe fëmijë në situatë rruge shërbyen për të provuar ekzistencën e problemeve, shkallën e tyre, shkaqet dhe nevojat për ndërhyrje si dhe për të marrë sugjerimet nga gjithë aktorët e interesuar.

Literaturat e përdorura kanë qenë ligje, VKM, raportet vjetore të Observatorit, strategji dhe politika rajonale, raporte të organizatave të tjera kombëtare dhe ndërkombëtare. Më shumë informacion rreth materialeve që Observatori Elbasan u është referuar, i gjeni te Literatura e përdorur.

Në kuadër të hartimit të Raportit të Situatës për Treguesit e Rinj janë ndërmarrë takime me:

- Zyrën e Statistikave të Prefekturës Elbasan
- Nën Prefekturat e Qarkut
- Drejtorinë Rajonale të Policisë, Shërbimit Social, Shëndetit Publik, Institucionet e Sigurimeve dhe Kujdesit Shëndetësor në Elbasan, Drejtorinë Arsimore Rajonale
- Komunitat e Qarkut Elbasan etj

Me secilën prej tyre ku ka pasur ndryshime të drejtuesve është bërë riprezantimi i punës së Observatorit, qëllimit të saj dhe mënyrës së funksionimit.

Ndërkohë që janë nënshkruar marrëveshjet e reja të bashkëpunimit në të mirë të rezultateteve të punës.

Përgatitja e këtij raporti u bë nëpërmjet një procesi që në vetvete kishte 2 komponentë kryesor, të dhënat statistikore dhe informacionet e marra nga takimet dhe intervista me aktorë lokalë.

Takimet dhe intervistat u kryen në Bashkinë Elbasan, me aktorë të cilët luajnë një rol të rëndësishëm në hartimin e plan veprimeve për fëmijë. U zhvilluan takimet me nxënës në Bashkinë Elbasan (me nxënës të shkollave 9-vjeçare) si dhe takime me nxënës të shkollave të mesme. Gjithashtu u kryen dhe vizita dhe vëshgime cilësore në ambientet e frekuentimit të ambienteve të ndryshme për fëmijë.

Gjithsej në takimet dhe intervistat morën pjesë 10 te rritur , 20 fëmijë nga Bashkia Elbasan.

Informacionet e marra nga takimet janë pjesë e gjetjeve të këtij raporti. Disa nga çështjet në të cilat u fokusuan intervistat me fokus grupet ishin:

1. A keni diskutuar ndonjëherë për të drejtat e fëmijëve?
2. Si e vlerësoni te drejtën e fëmijëve për arsim në njësinë tuaj vendore?
3. Cilat janë problemet kryesore?
4. Sa cilësore janë shërbimet shëndetësore për fëmijët?
5. A dini raste të pamundësisë së familjeve për të ndjekur problemet shëndetësore të fëmijëve të tyre jashtë zonës?
6. A janë fëmijët pjesë e vendimmarrjes?
7. A vaksinohen rregullisht fëmijët dhe deri në çfarë niveli është shkalla e imunizimit?

Raporti ka kufizimet e veta në pasqyrimin e një tabloje të plotë të situatës së të drejtave të fëmijëve në qarkun Elbasan, të cilat mund t'i përmbledhim si më poshtë:

- Edhe pas miratimit me Ligj të treguesve të Rinj dhe VKM përkatëse për shkëmbimin e informacionit, aksesit i tyre krijon është mjaft i vështirë për përgatitjen e informacioneve të duhura.
- Duke qenë se formulari sipas ligjit të mësipërm i përgatitur synon monitorimin dhe vlerësimin për politik-bërjen në nivel kombëtar, treguesit janë deri në nivel qarku. Kjo bën që raporti të vlejë për krahasim në këtë nivel, pa dhënë mundësinë e evidentimit të situatës në nivel njësisish vendore (komuna dhe bashkitë përkatëse të Qarkut).

Megjithë limitizimet e raportit, ai mund të ndihmojë aktorët lokal, rajonal dhe kombëtar në hartimin e politikave dhe zbatimin e tyre, për kategoritë e fëmijëve të cilët kanë nevojë për një ndërhyrje të menjëhershme.

III - Analiza e situatës së të drejtave të fëmijëve bazuar në treguesit e parashikuar në ligj

1. Përshkrim i përgjithshëm i situatës së të drejtave të fëmijëve në nivel Qarku

Qarku Elbasan shtrihet në zonën qendrore të Shqipërisë. Kryeqendra është qyteti i Elbasanit. Popullata e këtij qarku ka hasur mjaft problematika sociale në këto vite tranzicioni. Më parë Qarku i Elbasanit njihej për Kombinatin Metalurgjik e një sërë Industrish të rënda si ajo e çimentos etj. Qarku i Elbasanit po rikuperon edhe nëpërmjet zhvillimit social, prezenca e një numri të madh OJF-sh dhe shërbimesh të ofruara prej tyre po sjell një tjetër pamje të tij.

Varfëria, abuzimi, shkollimi i pamjaftueshëm, shkelja e të drejtave të fëmijëve, jetesa në kushte të vështira social ekonomike, punësimi i fëmijëve, mungesa e shërbimeve të mjaftueshme dhe pranë janë fenomene që kërkojnë ndërhyrje politikash dhe buxhete me fokus fëmijët .

Në Qarkun e Elbasanit fëmijët (popullata 0-18 vjeç) përbën 28 %,²ose 121.692 fëmijë³ (viti 2010). Nisur nga kjo shifër e konsiderueshme e popullatës është e nevojshme të punohet edhe më shumë. Në kuadër të përmirësimit të të drejtave të fëmijëve në Qarkun Elbasan nga muaji Tetor dhe deri në muajin Mars janë organizuar shpesh tryeza të rrumbullakta me në fokus fëmijët, një hap ky i rëndësishëm në përmirësimin e situatës.

Në këto takime kanë marrë pjesë përfaqësues nga Qarku Elbasan, bashkitë dhe komunat e tij, Observatori për të Drejtat e Fëmijeve, OJF-ve lokale, përfaqësues të Drejtorive Rajonale, donatorë që punojnë në Elbasan si Terres des Hommes etj .

Të gjithë pjesëmarrësit e lartpërmendur janë aktorë thelbësorë në zhvillimin e politikave për fëmijët.

Në Qarkun e Elbasanit tashmë operojnë shumë OJF të cilat përmirësojnë cdo ditë e më shumë jetën e qytetareve e si rrjedhojë edhe atë të fëmijëve.

Ofronjë shërbime për fëmijët, por lokalizimi i tyre është Bashkia Elbasan dhe kjo përbën problem për mos mbulimin më shërbim të bashkive dhe komunave të tjera. Pushteti lokal nuk ofron shumë fonde në kuadër të shërbimeve për fëmijë kjo edhe si pasojë e prioriteteve në fusha të tjera.

Një nga fenomenet e përsëritura mbetet mos regjistrimi i fëmijëve romë sidomos atyre që kanë lindur jashtë Shqipërisë, për të përmirësuar këtë situatë Observatori Elbasan po punon ngushtë me Drejtorinë e Kujdesit në Qarkun Elbasan, nëpërmjet Nismës së saj ONE STOP SHOP.

2. Aksesit ndaj shërbimeve sociale të ofruara për të plotësuar nevojat dhe problemet e fëmijëve

Në 4 nëntor të vitit 2010 Parlamenti Shqiptar miratoi ligjin 10 347 “Për mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve”, i cili ka për qëllim të marrë masat që çdo fëmijë të gëzojë të drejtat e tij në përputhje me stadin e zhvillimit të tij, të sigurojë mbijetesën, jetesën, dhe zhvillimin e fëmijëve. Monitorimi i të drejtave të fëmijëve është parashikuar në ligj, duke ngritur kështu edhe strukturat institucionale dhe mekanizmat për këtë qëllim⁴.

Analiza e treguesve do bëhet sipas 8 fushave kryesore si më poshtë.

- Tregues demografike
- Tregues të varfërisë monetare (varfëria absolute)
- Tregues të përkujdesjes social
- Tregues të shëndetit
- Tregues të dhunës në familje, trafikimit, gjakmarrjes dhe mbrojtjes
- Tregues të drejtësisë për të miturit
- Tregues të punësimit të fëmijëve
- Tregues të arsimimit të fëmijëve

Në zbatim të ligjit të mësipërm, Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës (ASHMDF) në bashkëpunim me ministrinë e linjës kanë ndërtuar një sistem treguesish të

³ Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, Ministria e Brendshme Tirane, 2012

⁴ VKM 265, date 12.4.2012 “Për krijimin dhe funksionimin e mekanizmit të bashkërendimit të punës ndërmjet autoriteteve shtetërore, përgjegjëse për referimin e rasteve të fëmijëve në rrezik, si dhe mënyrën e procedimit të tij”.

monitorimit të të drejtave të fëmijëve në nivel kombëtar dhe rajonal duke iu bashkangjitur këtij ligjit me anë të disa VKM. Treguesit janë të ndarë në 8 fusha dhe 21 ndarje si më poshtë Bazar në këto tregues , aksesit i shërbimeve për fëmijë në Qarkun Elbasan vijon si më poshtë:

IV - Analiza e treguesve

Mirëqenia dhe interesi më i lartë i fëmijëve, është boshti i analizës së mëposhtme në këtë raport. Nga pikëpamja sociologjike dhe psikologjike mirëqenia përshkruhet me termin e “kënaqësi ndaj jetës” dhe të “lumturisë” që çdo individ ka arritur, krahasuar me aspiratat dhe synimet e projektuara⁵.


Pavarësisht punës së bërë nga të gjithë aktoret lokale dhe kombëtarë, fëmijët vazhdojnë të jenë një grup pak i vlerësuar dhe përfaqësuar kur vjen puna për respektimin e të drejtave të tyre. Mentaliteti mbetet një problem, që ndikon negativisht në konsiderimin e fëmijëve si partnerë brenda familjes dhe në komunitet.

Gjithashtu niveli ekonomik është një tjetër faktor që ndikon në fokusimin e pakët tek njohja dhe respektimi i të drejtave të fëmijëve. Problemet e jetesës nga njëra anë e bëjnë të vështirë vendosjen e një komunikimi të vazhdueshëm dhe funksional mes prindërve dhe fëmijëve, nga ana tjetër mundësitë e familjeve për të marrë në konsideratë nevojave e fëmijëve që lidhen me burime financiare janë të kufizuara.

Tregues demografikë

Për vitin 2012 në qarkun e Elbasanit numri i fëmijëve është 121.692⁶ gjithsej ose 28 % e popullsisë totale në qark (Sipas DPGJC Tiranë). I ndarë sipas grupmoshave numri i fëmijëve jepet në grafikun e mëposhtëm:

Grafiku nr 1.Ndarja e grupmoshave në Qarkun Elbasan



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, Ministria e Brendshme Tiranë, 2013

Janë 52.976 fëmijë⁷ gjithsej që i përkasin grupmoshës 0-6 vjeç, e shprehur në % ky numër zë rreth 43 % të numrit total të fëmijëve. 61.310 fëmijë⁸ i përkasin grupmoshës 6-15 vjeç, ose rreth 50 % e numrit total të fëmijëve. Ndërsa grupmoshës 15-18 vjeç i përkasin 20.216 fëmijë⁹, ose

⁵ Matja e mirëqenies së fëmijëve në Shqipëri duke përdoruar vrojtimet MICS dhe ADHS, V Kolpeja,

⁶ Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, Ministria e Brendshme Tirane, 2012;

⁷ Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, Ministria e Brendshme Tirane, 2012


⁸ Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, Ministria e Brendshme Tirane, 2012

⁹ Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, Ministria e Brendshme Tirane, 2012

rreth 17 % të fëmijëve. Nga grafiku duket qartë që gjysma e fëmijëve janë në arsimin e detyruar. Po ashtu fëmijët në arsimin parashkollor (kopshte) janë afro gjysma dhe në arsimin e mesëm janë në % më të vogël.

Në fakt numri i fëmijëve i përdorur me sipër është marrë nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile (DPGJC) në Tiranë. Në nivel qarku numri i fëmijëve në total dhe sipas njësive vendore nuk rezulton si e dhënë pasi zyrat e gjendjes civile pranë njësive vendore nuk e kanë aktive atë pjesë të sistemit që bën të mundur nxjerrjen e të dhënave nga regjistrat e popullsisë. Për sa i përket ndarjes së numrit të fëmijëve sipas gjinive, ky informacion është bërë i disponueshëm si e dhënë bazë këtë vit, për Qarkun e Elbasan (përfshirë ndarja në njësi vendore) ky informacion vijon si më poshtë:

Grafiku 2: Numri i fëmijëve të ndarë sipas grupmoshave dhe gjinise për Qarkun e Elbasanit



Burimi: Drejtoria e Pergjithshme e Gjendjes Civile, Ministria e Brendshme Tirane, 2013


Numri i fëmijëve ne Qarkun Elbasan, i ndarë sipas gjinisë është përkatësisht:

Për grupmoshën 0-6 vjeç janë të regjistruar 25702 femra dhe 27274 meshkuj¹⁰.

Për grupmoshën 6-15 vjeç janë të regjistruar 29440 femra dhe 31870 meshkuj, dhe për grupmoshën 15-18 vjeç janë regjistruar 9757 femra dhe 10459 femra.

Siç vihet re dhe nga grafiku shohim një numër më të madh të gjinisë mashkullore.

Grafiku 3: Numri i fëmijëve të ndarë sipas grupmoshave dhe gjinise për Rrethin e Elbasanit




Burimi: Drejtoria e Pergjithshme e Gjendjes Civile, Ministria e Brendshme Tirane, 2013

Në rrethin e Elbasanit për grupmoshën 0-6 vjeç janë të regjistruar 17404 meshkuj dhe 16176 femra. Për grupmoshën 6-15 vjeç janë të regjistruar 20245 meshkuj dhe 18486 femra. Dhe për grupmoshën 15-18 vjeç janë të regjistruar 6544 meshkuj dhe 6052 femra¹¹.

¹⁰ Drejtoria e Pergjithshme e Gjendjes Civile, Ministria e Brendshme Tirane, 2013


Grafiku 4: Numri i fëmijëve të ndarë sipas grupmohave dhe gjinise për Rrethin e Gramshit



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, Ministria e Brendshme Tirane, 2013

Në rrethin e Gramshit janë të regjistruar 2279 meshkuj dhe 2226 femra për grupmoshën 0-6 vjeç. 2657 meshkuj dhe 2555 femra për grupmoshën 6-15 vjeç Dhe 876 meshkuj dhe 856 femra¹¹për grupmoshën 15-18 vjeç.


Grafiku 5: Numri i fëmijëve të ndarë sipas grupmohave dhe gjinisë për Rrethin e Librazhdit



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, Ministria e Brendshme Tirane, 2013

Në rrethin e Librazhdit janë të regjistruar 5117 meshkuj¹² dhe 4896 femra për grupmoshën 0-6 vjeç 6058 meshkuj dhe 5832 femra për grupmoshën 6-15 vjeç Dhe 6544 meshkuj dhe 6052 femra për grupmoshën 15-18 vjeç.

Grafiku 6: Numri i fëmijëve të ndarë sipas grupmohave dhe gjinisë për Rrethin e Peqinit



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, Ministria e Brendshme Tirane, 2013

¹¹ Drejtoria e përgjithshme e Gjendjes Civile, Ministria e Brendshme Tiranë 2013

¹² Drejtoria e përgjithshme e Gjendjes Civile, Ministria e Brendshme Tiranë 2013

Në rrethin e Peqinit janë të regjistruar 2474 meshkuj dhe 16176 femra për grupmoshën 0-6 vjeç. 2910 meshkuj dhe 2567 femra për grupmoshën 6-15 vjeç. Dhe 1003 meshkuj dhe 963 femra¹³ për grupmoshën 15-18 vjeç.

Lidhur me numrin e familjeve për vitin 2012¹⁴, sipas të dhënave të DPGJC Tiranë, qarku ynë në këtë vit ka të regjistruara 117428 familje gjithsej, nga të cilat rrethi Elbasan ka 78809 familje, rrethi Peqin 9692 familje, rrethi Gramsh 9239 familje dhe rrethi Librazhd ka 19688 familje.

Tregues të varfërisë monetare (varfëria absolute)

Elbasani është ndër rajonet me nivel të ulët ekonomik¹⁵. Numri i madh i familjeve në NE është një ndër treguesit për këtë. Nga takimet dhe intervistat në rrethet e qarkut Elbasan, ekzistojnë familje të cilat jetojnë në kushtet e varfërisë ekstreme, por nuk ka statistika apo vlerësime periodike për numrin apo përqindjen e kësaj kategorie ndaj totalit. Një pjesë e tyre nuk janë as në skemën e NE, për arsye se ato kanë në pronësi një sipërfaqe toke e cila pavarësisht faktit se aftësitë prodhuese e tokës janë të e ulëta këto familje përjashtohen nga marrja e NE. Ndërkohë që jashtë skemës së trajtimit mbeten ende fëmijët pa kujdes prindëror dhe që nuk trajtohen me shërbime rezidenciale apo fëmijë të prindërve të cilët kanë gabuar në plotësimin e procedurave të Skemës së Ndhmës Ekonomike e si pasojë fëmijët mbeten pa përfituar.

Rreth 10.816 familje¹⁶ me fëmijë të moshës 0-18 vjeç janë mbështetur me NE në qarkun e Elbasanit për vitin 2012.

Nga numri i mësipërm i familjeve në NE rreth 1019 familje¹⁷ drejtohen nga kryefamiljare gra. Nuk ka të dhëna që fëmijët jetojnë vetëm me të atin. Familjet në të cilat kontributi prindëror është vetëm nga nëna, përballen me probleme të tjera.

Ndryshimet në strukturën e familjes kanë ndikim në mirëqenien e fëmijës. Fëmijët në familje një-prindërore kanë risk më të lartë për të pasur zhvillim psiko-social më të ulët krahasuar me fëmijët që jetojnë me të dy prindërit¹⁸.

Situata e familjeve që mbështeten me NE paraqitet si në vijim:

¹³ Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, Tiranë 2012

¹⁴ Te dhena te siguruar nga Observatori Kombëtar, Tiranë Mars 2012;

¹⁵ Shërbimi Social Shtetëror, Elbasan 2012

¹⁶ Shërbimi Social Shtetëror, Elbasan 2012

¹⁷ Shërbimi Social Shtetëror, Elbasan 2012

¹⁸ Matja e mirëqenies në Shqipëri duke përdorur vrojtimet MICS dhe ADHS, V. Kolpeja;

Tabela 1: Familjet që mbështeten me NE

Grupmosha	0-18 vjeç
Qarku Elbasan	10816
Rrethi Elbasan	5451
Rrethi Librazhd	3213
Rrethi Gramsh	1141
Rrethi Peqin	1011

Burimi: Shërbimi Social Shtetëror Elbasan, 2012

Për sa i përket ndarjes në grupmosha të fëmijëve familjet e të cilëve mbështeten me NE, situata paraqitet e tillë:

Tabela 2: Numri i familjeve që mbështeten me NE të ndara sipas grupmoshave të fëmijëve

Grupmoshat	Nr. i familjeve me NE
Me fëmijë 0-6 vjeç	3986
Me fëmijë 6-15 vjeç	4772
Me fëmijë 15-18 vjeç	2058

Burimi: Shërbimi Social Shtetëror Elbasan, 2012

Tregues të përkujdesjes sociale

Kur mendojmë për mbrojtjen sociale secilit nga mendon për shërbimet ditore apo rezidenciale .

Referuar Strategjisë Lokale për Personat me Aftësi të Kufizuar, 7 organizata ofrojnë shërbime për kategoritë e fëmijëve me disavantazh. Ndërkohë që këtyre organizatave i shtohen edhe Dega e Aleancës për fëmijë, World Vision të fokusuar në projekte për rrjetin e fëmijëve, shërbimeve në forcimin e komunitetit për të drejtat e fëmijëve dhe në sistemin e monitorimit dhe raportimit të drejtave të fëmijëve në Qarkun Elbasan.

Impakti i projekteve të OJF-ve në qytet është pozitiv dhe mbështetës nga grupet në nevojë me pjesëmarrjen e tyre, por projektet janë kryesisht jo të qëndrueshme.

Fëmijët me nevoja të veçanta janë ndër kategoritë e fëmijëve të cilët kanë nevojë për përkujdesje të veçantë sociale. Bazuar në “DISPOZITA NORMATIVE” për “Për arsimin parauniversitar”, në KREU VIII “FËMIJA PARASHKOLLOR DHE NXËNËSI”, Neni 36 “Të drejtat”, pika 7 thuhet që: “Fëmijët me aftësi të kufizuara mendore apo fizike të rënda, në pamundësi të trajtohen në shkollat e veçanta, mund të trajtohen në institucione të tjera, sipas rastit”.

Fëmijët me nevoja të veçanta janë një ndër grupet më të rrezikuar në Qytetin e Elbasanit dhe më gjerë, për sa i takon standarteve të ulta ekonomike, mundësive të pakëta të arsimimit, me mundësi të kufizuara lëvizjeje, me të drejta njerëzore përgjithësisht të kufizuara dhe me prezencën e një realiteti dhe mentaliteti social jo shumë integruar. Të drejtat dhe liritë e Personave me Aftësi të Kufizuara janë të sanksionuara në Akte dhe Konventa të shumta Ndërkombëtare si dhe në Kushtetutën e Shqipërisë.¹⁹

Gjithashtu përkujdesja sociale përfshin dhe kategorinë e fëmijëve familja e të cilëve nuk mund të ndërhyj në zgjidhjen e një problemi shëndetësor. Për këtë arsye familja kërkon ndihmë në organet lokale zgjidhjen e problemit. Kështu është rasti i një fëmije i cili ka nevojë urgjente për operacion:


R. është rasti një djali i cili ka nevojë urgjente për kryerjen e një operacioni, por familja nuk është në gjendje ta përballojë këtë operacion. Prindërit i janë drejtuar për ndihmë NJDF në Qark për zgjidhjen e këtij problemi, por ato nuk kanë mundur të bëjnë grumbullimin e shumës së nevojshme. Nëna kërkon ndihmë urgjente, për të shpëtuar jetën e djalit të saj. Cfarë do të bëhet më

Tregues të shëndetit

Shërbimi shëndetësor mbetet një nga shërbimet shtetërore primare në Qarkun e Elbasanit. Përmirësimi i cilësisë shihet në ofrimin e shërbimeve në Klinika Private falë teknologjisë që ata sjellin por edhe mirëmbajtjes së aparaturave, por kostot e vizitave në to mbeten ende të larta dhe jo çdo familje ka mundësinë për të marrë shërbime në to. Klinikat private edhe pse ofrojnë shërbime nëse kërkon të dhëna për to nuk ta ofrojnë informacion sepse ende nuk janë të regjistruara si të tilla.

Grafiku 7 Institucionet Shëndetësore Publike, Qarku Elbasan

¹⁹ Strategjia Lokale dhe Ndërhyrja Strategjike për Personat me Aftësi të Kufizuara Bashkia Elbasan 2012-2017.



Burimi: ISKSH Elbasan, 2012

Një pjesë e konsiderueshme e vizitave për fëmijët që kërkojnë një shërbim më të specializuar për qarkun ofrohen në Spitalet e Elbasanit siç ndodh edhe në Pediatri ndërkohë që rastet më të rënda marrin shërbim në Komplekset spitalore të Tiranës ose Shtetit Maqedonas.

Problematike mbetet ofrimi i shërbimeve në komunat e Qarkut pasi atje mungojnë pajisjet e urgjencave në Qendra Shëndetësore apo Ambulanca dhe ajo që e rrit më tepër riskun e situatës dhe problematikat stimore në prag të stinës së dimrit.

Nga vëzhgimet në terren si dhe nga informacionet e marra në takimet dhe intervistat personeli shëndetësor është në dispozicion të ofrimit të shërbimeve, duke alternuar shërbimet pranë strukturave shëndetësore me shërbimet pranë familjes sipas mundësive të pacientëve.

Për vitin 2012, nga të dhënat e marra në DSHP Elbasan, rezulton që shkalla e Imunizimit sipas parashikimeve në ligj kryhen në masën mbi 99 %²⁰. Një tregues i rëndësishëm ky për cilësinë e jetës së fëmijëve dhe rrezikshmërisë ë vdekshmërisë.

Megjithatë edhe për treguesit e shëndetit nuk ka informacione të plota në nivel qarku. Megjithëse është DSHP Elbasan që mbulon qarkun, zyrat përkatëse në Gramsh, Peqin dhe Librazhd nuk raportojnë pranë DSHP Elbasan, por shkëmbimin e informacionit e kanë me Ministrinë e Shëndetësisë. Kjo e bën të vështirë marrjen e informacioneve të plota lidhur me treguesit e shëndetit për Qarkun Elbasan.

Gjithsesi janë disa grupe të dhënash për të cilat informacioni zyrtar mungon pothuaj plotësisht. Një grup i tillë janë personat me HIV/AIDS. Zyrtarisht ky numër është 0²¹. Kjo pasi nuk ka pasur persona të cilët të kenë kërkuar ndihmë për këtë problem pranë qendrave në Elbasan. Zakonisht këto persona marrin një kurim të specializuar në Tiranë. Një gjë e tillë e bën të vështirë marrjen e informacioneve edhe për strukturat shëndetësore në nivel qarku. Gjithashtu

²⁰ DSHP, Elbasan2012

²¹ DSHP, Elbasan 2012

dhe përdorimi i substancave të dëmshme nga fëmijë rezulton në shifrën 0, kjo pasi shpesh nuk bëhet raportimi i saktë nga institucionet përkatëse, ose kemi një fshehje të këtij informacioni.

Tregues të dhunës në familje, trafikimit, gjakmarrjes dhe mbrojtjes

Në nivel komuniteti dhe familje dhuna ndaj fëmijëve unifikohet vetëm me dhunën fizike ndaj tyre, ndërsa format e tjera nuk konsiderohen të pranishme dhe nuk njihen si problem²². Por deri tani nuk ka të dhëna statistikore lidhur me shkallën e përdorimit të formave të ndryshme të dhunës në familje dhe komunitet dhe që godet fëmijët.

Elbasani është një komunitet paqësor, pavarësisht problemeve ekonomike dhe sociale me të cilat përballen komunitetet rurale. Gjakmarrja nuk është një fenomen që haset në Elbasan. Nuk ka raportime të këtij fenomeni nga familjet.

Lidhur me mbrojtjen e fëmijëve gjatë vitit 2012 janë shënuar hapa të rëndësishëm pozitive. Në nivel qarku ka funksionuar NJDF.

Nga informacionet e marra, modeli më pozitiv në nivel qarku është Bashkia Elbasan, në të cilën NJMF ka vazhduar me identifikimin dhe asistimin e rasteve konkrete të fëmijëve me probleme.

Gjatë vitit 2013 nga NJMF Peshkopi janë mbështetur këto raste si më poshtë :

Tabela 3: Rastet e mbështetura dhe raportuara nga NJMF Elbasan, viti 2013

Komuna/ Zona ku është identifikuar rasti (Komuna/ bashkia)	Problem/ lloji i rastit	Niveli I rrezikut të fëmijës
Komuna Shirgjan	Nëna e dy fëmijëve me probleme mendore rrezikon jetën e fëmijëve	Rrezikimi i Jetës
Bashkia Elbasan	Pamundësi Financiare nga familja për mbajtjen e femijëve	Kushte të mjerueshme 3 Fëmijë
Komuna Girbe	Kujdes Ligjor për të miturin i cili jeton i vetëm prej një muaji	Kujdes Ligjor për fëmijën

Burimi: NJMF Elbasan, 2013

Për secilin nga rastet e Tabelës 1 jo vetëm është dhënë asistencë e nevojshme, por janë hapur dosje të posaçme dhe secili rast është ndjekur në vazhdimësi nga punonjësja e NJDF. Të gjitha rastet e paraqitura me sipër kanë marrë zgjidhje me mbështetjen e NJMF Elbasan dhe në partneritet mes aktorëve lokal dhe rajonal²³.

Tregues të drejtësisë për të miturit

Treguesit e drejtësisë për të mitur ashtu si dhe në disa grupe të tjera treguesish janë me informacione të limituara dhe të rezervuara. Gjithashtu nuk ka ndarje informacioni mes strukturave të policisë ndërmjet rretheve në qark. Pavarësisht se përfaqësues të strukturave policore dhe gjyqësore janë pjesë e aktiviteteve rajonale që synojnë mbrojtjen më të mirë të fëmijëve, informacionet që ato disponojnë për fëmijët konsiderohen si kategori që nuk mund të bëhet publike.

²² Observatori Elbasan, Raportet vjetore 2008, 2009 dhe 2010.

²³ NJMF, Elbasan 2012

Vazhdimi i sigurimit të informacionit dhe statistikave edhe është ndër synimet e punës së Observatorit në vazhdim.

Tregues të punësimit të fëmijëve

Në nivel rajonal vlera e shkallës së punësimit të fëmijëve në numër është “0”²⁴.

Puna e fëmijëve ndeshet në grumbullimin e bimëve mjekësore, mbledhjes së lëndëve dytësore për përpunim. Raste këto të cilat ndeshen çdo ditë në rrugët e qytetit tonë.

Fëmijët gjithashtu bëjnë punë në shërbim të familjes, kryesisht kullotjen e bagëtive, punojnë në punët e bujqësisë sipas nevojave.

Në rastin e bimëve mjekësore fëmijët përgjithësisht shoqërohen nga prindërit gjatë procesit, gjithsesi kjo ndodh kryesisht gjatë periudhës së pushimeve të verës. Një pjesë e mirë e të ardhurave të siguruar nga prindërit dhe fëmijët në këtë rast përdoren për përgatitjen e fëmijëve për shkolle në vitin në vazhdim.

Kjo ndodh për faktin se të ardhurat që sigurohen nga prindërit janë shumë të pakta, bën të domosdoshëm edhe angazhimin e fëmijëve. Nuk ka të dhëna numerike mbi numrin e fëmijëve të angazhuar në këtë punë. Por, nga puna jonë si Observator është konstatuar në terren se numri i të miturve që punojnë është i konsiderueshëm.

Tregues të arsimimit të fëmijëve

Treguesit të arsimimit të fëmijëve, tregojnë qartë emancipimin e një shoqërie dhe vlerësimin dhe punën për zhvillimin e personalitetit, talentit, aftësisë mendore dhe fizike për të arritur në potencialet e fëmijëve në të ardhmen. Pasi janë fëmijët ato të cilët do t’i shërbejnë shoqërisë shqiptare në të ardhmen.

Edukimi dhe arsimi i fëmijëve fillon që në hapat e para në moshën 0-6 vjeç. Situata në arsimin parashkollor në rrethin e Elbasanit paraqitet e tillë:

Janë 134 Kopshte Publike dhe Private në rrethin Elbasan. Gjithashtu është konstatuar një shtrirje e mirë e tyre në bashkitë dhe komunat përreth tyre, në mënyrë që asnjë fëmijë të mos mbetet i përjashtuar. Numri i edukatoreve të cilët japin mësim në rrethin Elbasan është 280. Niveli i regjistrimit në Arsimin Parashkollor 5510 fëmijë²⁵.

Në rrethin e Elbasanit numri i shkollave 9-vjeçare është 169. Numri i mësuesve të cilët japin mësim në këto shkolla është 1663 dhe numri total i nxënësve të regjistruar në arsimin e detyrues ka qenë 25.099²⁶ nxënës.

Në rrethin e Elbasanit për vitin 2012, sipas të dhënave të marra në DAR Elbasan, numri total i shkollave të mesme është 32, në të cilat japin mësim 503 mësues.

Ndërsa në arsimin e mesëm janë regjistruar 8173 nxënës²⁷.

²⁴ Shërbimi Kombëtar i Punësimit, 2013


²⁵ DAR ,Elbasan 2012

²⁶ DAR Elbasan, 2012

²⁷ DAR, Elbasan 2012

Numri i nxënësve në klasa në ciklin e ulët të arsimit të detyruar sipas të dhënave të përlogaritura nga punonjësit e statistikave pranë DAR Elbasan, është mesatarisht 30 nxënës në klasë në qytet dhe 20 nxënës²⁸ në klasë në fshat.

Grafiku: Shkalla e rregjistrimit në Arsim



Burimi: DAR Elbasan 2012.

Sipas nenit 37 të Dispozitave Normative të sistemit Parauniversitar është parashikuar parimi i pjesëmarrjes së fëmijëve në jetën e shkollës si individë dhe si organ vendimmarrës i organizuar, përmes ngritjes së strukturës së qeverisë së nxënësve. Ajo që u evidentua nga takimet me nxënësit dhe mësuesit është që situata e të drejtave të fëmijëve tashmë ka ndryshuar dhe po ndryshon për mirë. Janë sot fëmijët, të cilët ngrënë zërin, por kjo ndodh kryesisht në shkollat e mesme dhe në zonat urbane. Këtu mund të vlerësojmë mjaft pozitivisht punën që kryen Zëri16+ si një strukturë e konsoliduar tashmë, por dhe rolin e Parlamentit Rinor në aktivizimin e tyre.

Fëmijë që braktisin shkollën

Sipas shifrave të Drejtorisë Arsimore Rajonale braktisja e shkollës ka një rritje në krahasim me vitin 2011-2012 nga 0.04%²⁹ që ishte kjo përqindje u rrit në 0.059%³⁰ në vitin shkollor 2012-2013, përsëri është evident si faktor social apo ajo që shpesh njihet si largimi në emigracion dhe të gjithë ne jemi koshientë që po shohim gjithnjë e më shumë fëmijë që lypin apo shesin në rrugë. Megjithëse janë bërë përpjekje të vazhdueshme që çdo fëmijë të ndjekë shkollën, përsëri braktisja ekziston si problem. Vihet re se shumica e fëmijëve e braktisin shkollën pas klasës së pestë.

²⁸ DAR, Elbasan 2012

²⁹ Raportet Vjetore Observatori 2010

³⁰ DAR, Elbasan 2012

IV - Prezantimi i gjetjeve kryesore

- Një pjesë e të dhënave nuk është e mundur të prodhohen në nivel lokal. Ky problem fillon që nga evidentimi i numrit të fëmijëve në nivel njësie vendore. Mungesa e këtij informacioni në këtë nivel, e bën të vështirë nxjerrjen e numrit total të fëmijëve në nivel qarku. Një gjë e tillë vështirëson gjithë punën e mëtejshme në monitorimin e respektimit të të drejtave të fëmijëve pasi nuk mund të matet niveli i aksesit.
- Njësitë vendore nuk kanë informacion për të gjitha çështjet që lidhen me popullsinë dhe territorin e saj.
- Varfëria absolute është një problem që ndeshet në Qarkun e Elbasanit. Përrjashtimi social sidomos për fëmijët e këtyre familjeve bën që atyre t'ju privohen pothuaj të gjitha të drejtat. Megjithatë nuk ka informacione numerike bazë mbi të cilët të përcaktohet numri i këtyre familjeve dhe fëmijëve.
- Punësimi i fëmijëve ndeshet në rrethin e Elbasanit dhe në disa raste ato janë të ekspozuar ndaj një shkallë të lartë rreziku. Niveli i ulët ekonomik në zonë dhe të ardhurat e pakta që sigurohen nga punësimi, bëjnë që fëmijët të llogariten si forca potenciale pune brenda familjes, megjithëse për shkak të moshës ato nuk janë të tillë.
- Fëmijët që jetojnë në familje që mbështeten me ndihmë ekonomike dhe që drejtohen nga kryefamiljare gra jetojnë në një shkallë të konsiderueshme përrjashtimi social, për shkak të mundësive të kufizuara financiare brenda familjeve të tyre.
- Nuk ka një informacion të saktë për përdorimin e substancave të dëmshme dhe pse vihet re jo vetëm pirja e duhanit, por dhe përdorimi i substancave të ndaluara të kategorisë së drogave të ndryshme.

V - Rekomandime

- Pas miratimit të ligjit 10347 datë 04.11.2010, duhet një punë e vazhdueshme për njohjen dhe zbatimin e mëtejshëm të këtij ligji nga ana e institucioneve dhe njësive vendore.
- Angazhimi i institucioneve në mbledhjen dhe monitorimin e treguesve të rinj duhet të jetë më i lartë, pasi një sistem i unifikuar treguesish për të drejtat e fëmijëve është në ndihmë për hartuesit e politikave kombëtare dhe rajonale në fushën e mbrojtjes së të drejtave të Fëmijëve
- Më shumë vëmendje ndaj përdorimit të drogës nga nxënësit e shkollave sidomos atyre të mesme. Të konsiderohet si tabu dhe të mos flitet për të, nuk do të thotë që këto probleme nuk ekzistojnë.
- Njësiti vendore duhet të jenë aktive në fushën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve.
- Duhet ndërhyrje urgjente nga njësiti vendore dhe strukturat e tjera lokale rajonale për të mos lejuar fëmijët të punojnë në proces pune me rrezik shumë të lartë, punë në të cilat sipas të dhënave nga vitet e kaluara ka pasur raste të humbjes së jetës së personave edhe të rritur.

Bibliografia

- Ligji 10347, datë 4.11.2011 “ Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës”
 - VKM 265, datë 12.4.2012 “Për krijimin dhe funksionimin e mekanizmit të bashkërendimit të punës ndërmjet autoriteteve shtetërore, përgjegjëse për referimin e rasteve të fëmijëve në rrezik, si dhe mënyrën e procedimit të tij”.
 - VKM 266, datë 12.4.2012 “Për bashkërendimin e veprimtarisë së mekanizmave në nivel qendror dhe vendor për çështje që lidhen me mbrojtjen e të drejtave të fëmijës”
 - Treguesit e rinj sipas listës së miratuar me VKM 267, datë 12.04.2012
 - Ligjin ", nr. 7952, datë 21.06.1995, "Për Sistemin Arsimor Parauniversitar” ndryshuar me Ligjin nr. 8381, datë 30.07.1998 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7952 “Për sistemin Arsimor Parauniversitar”.
 - Ligji Nr. 9355, datë 10.3.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”.
 - Profili i varfërisë së fëmijëve në Shqipëri, A. Ceni, UNICEF 2011
 - Raportet vjetore të përgatitura nga Observatori Elbasan për vitet 2008,2009,2010
 - Raportet kombëtare 2008, 2009 dhe 2010, të përgatitur nga Observatori Tiranë
 - Të dhëna statistikore mbi popullsinë, të dërguara nga Zyra e Observatorit Tiranë
 - Matja e mirëqenies në Shqipëri duke përdorur vërtetimet MICS dhe ADHS, V. Kolpeja
- Strategjia Lokale dhe Ndërhyrja Strategjike për Personat me Aftësi të Kufizuar Bashkia Elbasan 2012-2017.

ANEKS : Pyetësi drejtuar specialistëve të institucioneve ne nivel vendor në Qarkun e Elbasanit, dhjetor 2013

1. Si ka ndikuar dhe a funksionon miratimi i ligjit 10 347 date 14.11.2010?
2. A janë ndërmarrë nisma apo projekte nga institucioni që ju përfaqësoni për Mbrojtjen Drejtave të Fëmijëve?
3. A jeni vene në dijeni për miratimin e VKM për mbledhjen dhe monitorimin e treguesve të rinj për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve?
4. Si është realizuar procesi i mbledhjes së treguesve të rinj nga institucioni juaj?
5. Sa bashkëpunues janë institucionet ne shkëmbimin e treguesve për të Drejtat Fëmijëve drejt OJF-ve?
6. Si është braktisja e shkollës në qytetin tuaj apo komunat përreth?
7. A ka raste të fëmijëve të paregjistruar dhe në menaxhimin e rasteve a është dhënë ndihma e institucioneve përkatëse?
8. Në qytetin tuaj a ka nevojë për qendra sociale apo rezidenciale dhe për cilin target-grup?
9. Sa është Shkalla e Imunizimit dhe e vaksinimit të Fëmijëve ?
10. Si paraqitet situata e punësimit të fëmijëve në qytetin tuaj?
11. Si e vlerësoni te drejtën e fëmijëve për arsim ne njësinë tuaj vendore?
12. Cilat janë problemet kryesore?
13. Cilësia e personelit shëndetësor dhe e shërbimeve shëndetsore.
14. A dini raste të pamundësisë se familjeve për te ndjekur problemet shëndetësore të fëmijëve te tyre jashtë zonës?
15. Si e vlerësoni situatën ekonomike të familjeve të njësisë suaj?
16. Cilat janë problematikat në fushën e realizimit të të Drejtave tuaja?